Shkolla do të kerkoje nga **Ethnic Minority Achievement Service** për një vizitë kur fëmija juaj fillon shkollën ose me gjete në se ato kanë ndonjë shqetësim. Kjo vizitë përfshinë marrjen në interviste të prinderve dhe mësuesëve dhe bëjnë punë me fëmijën me ndihmën e përkthyesit në se është e nevojshme.

### **Ethnic Minority Achievement Service**

Mësuesit do të gjejne prejardhjen e fëmijës llojin e edukimit ai/ajo ka dhe nivelin e anglishtes gjithashtu. Shoqata pastaj këshillon shkollën për sa i përket ndihmës që nxënësi ka nevojë me mësu anglishten.

**Disa** shkolla kanë **EMAS** mësues që punojnë gjatë gjithë vitit shkollor ne se ka ndonjë EMAS mësues në këte shkollë ai ose ajo do ju japin një takim brenda javeve të para të mbërritjes së fëmijës

tuaj. Ato gjithashtu do të mundohen të gjejnë përkthyes për ju nëse ju keni nevojë. **EMAS** mund të kontaktohen në:

**Tel: 0117 9031365.**

EMAS ka gjithashtu skuadren e azilantëve dhe azil kërkuesve për me ndihmë shkollat me nxënës të sapo arritur. Kjo kompani mund të kontaktohet në:

**Tel:0117 903 1279**

### **ÇFARË NDIHME ËSHTË E MUNDSHME PËR NXËNËS NË LËVIZJE DHE MAGJYPËT**

Bristoli ka një pjesë grupi të LEAs që ka në shërbim dhe përkrahje edukuese specifike për nxënës në lëvizje dhe magjypët (ACTES-Avon Consortium for Traveller Education Service).

Ato mund të bëjnë vlersime, afrojnë burime dhe kontaktojnë me familjet. Ato po ashtu afrojnë pakete mësimi distancuese dhe përkrahje në shkollë.

ACTES mund të kontaktohet në:

**Avon Consultium for Traveller education Service  
Charborough Road, Filton, Bristol BS 34 7RA**

**Tel: 01454 862620**

**[www.southglos.gov.uk/traveller\\_ed](http://www.southglos.gov.uk/traveller_ed)**

## Pyetje të tjera të rendësishme

### PO RRETH PJESËMARRJES?

Sapo fëmija ka filluar shkollën, është përgjegjësia e prindërit/kujdestarit për të siguruar që fëmija merr pjesë në shkollë çdo ditë që shkolla është e hapur, dhe që ato të mbërrijnë në kohë. Kjo është një kerkese legale, ka një përjashtim që mund ta ndalojnë fëmijën tuaj nga shkuarja në shkollë dhe ky rast është i pashmangur (kjo zakonisht kuptohet kur fëmija është i sëmurë ).

Shkolla mund të rregjistrojë mungesën e fëmijës si të **autorizuar** – kur arsyet e mungesa se femijes jane të pranueshme, ose **jo te autorizuar** – kur shkolla nuk jane të kenaqur me arsyet e mungeses se femijes. Ju duhet të telefononi që në **diten e pare** të mungeses së femijes, dhe të jepni shpjegim, ose dergoni një shenim me arsyet e mungeses.

Prinderit e femijeve më me teper se 20 mungesa të pa atorizuara në një periudh prej 10 javesh mund të referohen tek Sherbimi Edukues i Mireqenies (EWS) për një konsiderat të një Gjobe fikse. Kjo është një gjobe për prinderit. Prinderit që kane një nivel te larte për mungesa të pa autorizuar mund të prosekutohen sepse nuk e kane derguar femijen tyre në shkolle, dhe mund të shkojne në burg.

Në qofte se levizni në një zone tjeter, ju lutem informone shkollen e femijes. Në qofte se keni ndonjë pyetje rreth pjesmarrjes në shkolle, kontaktoni Sherbimi Edukues së Mireqenies:

**Tel: 0117 903 1660 (për femijet e shkolles dytsore)**

**Tel: 0117 903 7098 (për femijet e shkolles fillore)**

## **ÇFARE DUHET TË BËJ NË QOFTE SE FEMIJA I IM ËSHTE I FRIKSUAR?**

Shkolla duhet të ketë rregulla kundrejt friksimit, dhe në qofte se femija i juaj është friksuar ju duhet të flisni me mesuesen e klases menjehere.

Në qofte se femija kercenohet nga ana rracore të çfare do lloji, ju duhet të kontaktoni shkollën. Ato duhet të plotesojnë një formë monitorimi, të investojnë dhe të marrin plane për të sqaruar problemin. Një fletushke që të shpjegon për të drejtat tuaja është e mundshme nga :

**Race Equality Officer Tel: 0117 903 7595 ose mund ta gjeni këtë fletushke në**

**[www.bristol-lea.org.uk/services/eit/incident.html](http://www.bristol-lea.org.uk/services/eit/incident.html)**

## **A DO TI RESPEKTOHET BESIMI FETAR E FEMIJES SIM?**

Besimi fetar i femijes suaj duhet të respektohet në çdo shkollë që ai/ajo merr pjesë. Fjalimet fetare në shkollat komunitare është një baze dhe shkollat duhet të mbulojnë fete kryesore.

Është e zakonshme që të gjithë femijet të marrin pjesë në mesimet e edukimit fetar dhe asablet, megjithatë prinderi ka të drejtë ta heq femijen e tyre nga këto aktivitete. Që ta besh kete ju duhet të flisni me mesuesin kujdestare.

## **ÇFARE ËSHTE PERJASHTIMI NGA SHKOLLA?**

Perjashtimi nga shkolla ka kuptimin që femija i juaj nuk lejohet të marrë pjesë në shkollë për sjellje të keqja. Vetëm drejtori ka të drejtën e perjashtimit nga shkolla.

Janë dy lloje perjashtimesh:

### **Perjashtim me periudh fikse**

Keto perjashtime jane për një periudhe të shkurte duke perfshire dhe kohen e drekes. Nxënësi duhet të kthehet mbas mbarimit së periudhes së perjashtimit. Në rastin e perjashtimit me teper se një dite, puna do ti dergohet dhe vlersohet nga shkolla. Ligji e lejon drejtorin ta perjashtojne një femije deri në 45 dite në çfare do viti shkollore.

### **Perjashtim Permenant**

Kjo po ashtu njihet si perjashtim. Kjo ka kuptimin se nxënësi nuk mund te kthehete në shkollë vetem ne qofte se ripranohet nga bordi drejtues ose nga paneli i apelimit. Në qofte se është i perjashtuar permanent nga shkolla, aautoritetet lokale (LEA) kane detyren e gjetjes se edukimit të pershtatshem. Kjo mund ti afrohet në ndonjë shkollë tjetër, në Bazën e Nxëneseve të Referuar ose duke e mesuar në shtepi (mesime shtepijake). Mund të shihni me poshte për detajet e Bazës se Nxëneseve të Referuar.

Në qofte se femija juaj është perjashtuar ju keni te drejte te perfaqsimi tek bordi drejtues i shkolles. Në qofte se Bordi i shkolles vazhdon te mbaje perjashtimin permenant te femijes, atehere ju keni të drejte të apeloni tek Apeli i Pamvarur. Kerkoni në shkollë informacione të metejshme në perjashtimin.

### **ÇFARE ËSHTE PRU (BAZA E NXËNESVE TË REFERUAR)?**

Baza e nxëneseve të Referuar janë shkolla të hapura dhe mbikqyrura nga autoritetet e edukimit lokal që afrojnë edukim për femijet e moshave të deturuara të cilet nuk kane marre edukim të pershtatshem. Fokusi kryesor e kesaj baze është që ti çojne keto femije në shkolla kryesore, dhe nxënësit mund të jene nena te

reja, nxënës të perjashtuar nga shkolla, patologjik shkollorë, femijet e semur etj.

## **PO RRETH SHQETESIMIVE MJEKSORE/SHENDETSORE?**

Kur ju mberrini në këtë vend ju duhet të regjistroheni me doktor familje. Ju do të ju kërkohej ti afroni shkolles informacione rreth shendetit për femijen tuaj.

Ka një Infermiere Shkolle e cila punon së bashku me prinderit, mesuesit, femijet dhe familjet duke afruar ndihme dhe perkrashje nga ana emocionale/sjellje ose shqetësime fizike që ju mund të kenë. Në fillim të shkollës fëmijë do të afrohet një kontroll për sy dhe kontroll i rritjes së fëmijës. Leja e juaj do të kërkohej për këto kontrole dhe ju do të informoheni për rezultatin.

Vizita të rregullta dhe konfidenciale do të ketë, që drejtohen nga infermierja e shkollës.

Është e këshillueshme që fëmija juaj të bëjë vizita të rregullta te dentisti. Okolisti për sy do të bëjë vizitë fëmijës tuaj falas.

### **PËR DETAJE TË MË TEJSHME :**

**Tel :0117 957 3206 (North Bristol NHS Trust)**

## **PO SIKUR UNË TË JEM KUJDESTARI I FEMIJËS DHE FËMIJA IM ËSHTË ‘NËN KUJDESIN’ E AUTORITETEVE LOKALE ?**

Të gjitha shkollat duhen të kenë rregulla dhe një mësues veçanërisht që kujdeset për fëmijët dhe që ju mund të flisni me të për çfarëdo që ju jua të shqetësuar. Ju duhet ta prezantoni veten tuaj me këto mësues ose mësues. Ka gjithashtu dhe shërbim specifik për të perkrashur të drejtat e fëmijëve që janë nën kujdesin dikujt tjetër ky shërbim quhet ECLAS dhe ata mund të kontaktohen në :

**Edukacion of Looket After Children Service  
1B Ambercombe Walk, Stockwood, Bristol BS14 8AN  
Tel :0117 3773 062**

## **SI MUND TA NDIHMOJ FËMINË TIM TË MËSOJË ANGLISHT?**

Në se fëmija është i ri në Angli është e rëndësishme që ai ose ajo të vazhdojnë të flasin gjuhën e pare. Kjo do ta ndihmojë që të mësojë gjuhën shtesë më shpejt, ju mund ta ndihmoni fëmijën tuaj duke i folur gjuhën e pare në shtëpi duke i lexuar histori në të dy gjuhët dhe diskutu punën e tyre në gjuhën e pare.

## **ÇFARË JANË UDHËTIMET E SHKOLLËS?**

Këto janë udhëtime edukative kur nxënësit nxirren nga shkolla , ata zakonisht janë për kënaqësi por ato janë edukative dhe jo pushime. Është shumë e rëndësishme të kompletimi dhe të ktheni, çfarë do forme që ju jepet, për qëllim udhëtimiti. Fëmija juaj nuk do jetë në gjendje të shkojë në udhëtim nëse ju nuk keni dhanë leje me shkrim. Shkolla mund t'ju ndihmojë për plotësimin e formave. Shpesh prindërit pyeten të paguajnë për udhëtimin.

Kur udhëtimiti është jashtë shtetit fëmija juaj ka me pasë nevojë me pasë pasaport ose viza në dokumentin e udhëtimit për të udhëtuar me shkollën.

**Ato që kanë pasaport jo Angleze duhet të jenë të sigurt që fëmija i ka të gjitha dokumentat përkatëse para se të japin leje që fëmija të shkojë në këtë udhëtim.**

## **A MUND TA MARR FËMIJËN JASHTË SHTETIT GJATË KOHËS QË ËSHTË NË SHKOLLË?**

Në se ju bëni dicka të tillë ju rrezikoni të humbasni vendin e shkolles për fëmijën, dhe ditët e munguara do të quhen mungesë. Të gjithë prindërit duhet të marrin pushime gjatë pushimeve të shkollës . Nëse fëmija nuk vjen në shkollë mësuesi kujdestar duhet

të dinë arsyen për mungesën. Shkolla ka një rregull që shtyen udhëtimet jashtë shteti ju mund të pyesni për këtë. Shkolla mund të vendosin të ju referojnë juve shërbimi edukues mirëqenës në se pushimet reflektojnë me mësimet e fëmijës.

## **ÇFARË MUND TË BEJ RRETH VAKTET NË SHKOLLË DHE DIETAVE SPECIALE?**

Shkollat afrojnë dhe marrin pagesë për një vakt në mesditë për fëmijët. Disa fëmijë kanë të drejten të hanë falas çdo ditë. LEAs nuk janë të deturuar të japin qumësht por në se ju doni është falas për fëmijët që kanë të drejtë me hanger falas. Po tani shumë shkolla japin fruta në mëngjez.

Në se ka diçka që fëmija juaj nuk e ha ju duhet të lini shkollës me ditë për këtë. Ka gjithmone ushqim vegjetarian dhe shkolla duhet të afrojnë ushqim **halal** në se ju kërkohet.

Flisni me shkollën në se keni ndonjë diet për fëmijën tuaj. Shumë fëmijë kanë vakte të paketuara nga shtëpia.

Ju mund të jepni pije por ujë zakonizht ka në shkollë.

Ndihmësi i drekës quhet ndihës supervaser për vaktet e shkollës (SMSAs) do ju ndihmojnë me çfarë do problemi ato janë antarë të shkollës.

Fëmijët që hajnë në shkollë duhet të dine të përdorin lugën thiken dhe pirunin . Ju lutemi tregoni shkollës në se fëmija juaj ka nevojë për ndihmë.

## **A KA FËMIJA I IM TË DREJT PER USHQIM FALAS NË SHKOLLË?**

Ushqim falas u jepet atyre fëmijëve që prinderit e tyre marrin:

- Të ardhura ndihmëse
- Të ardhura për ato që kërkojnë punë
- Përkrahje nën pjesën V1 të ligjeve të emigracionit dhe azil kërkuarit akti 1999
- Taks kredit i fëmijës, ose kush nuk ka të drejtë për taks kredit pune
- Të ardhura vjetore që shqyrtohen nga arka e shtetit(Inland Revenue)] që nuk kalon 13, 480 sterlina

Fëmijët që marrin **Të ardhura ndihmëse** ose **të ardhura për ato që kërkojnë punë** kanë të drejtën për ushqim falas .

Në se ju mendoni se ju takon ju mund të pyesni shkollën për një form me plotësu ose kontaktoni seksionin e vlerësimeve në :

**Tel: 0117 903 6666**

## **PO RRETH UNIFORMES SHKOLLORE?**

Shkollat e Bristolit varen nga rregullat e veta për sa i përket uniformave, dhe ju keni me pasë nevojë me pyete çfare kerkohet. Shume shkolla kane uniforme për veshje ditën, e nje tjeter për fiskulture ose edukim fizik dhe aktivitet sportive.

Ne qofte se femija juaj ka nevojë me veshe veshje te vecante për arsye fetare ju duhet te pyesni mesuesin kujdestare rreth kesaj çeshtje.

Kostumet fetare duhet te rrespektohen ne shkolle.

Te gjithë duhet ti mbajne floket te rregullta dhe te pastra keshtu qe nuk mund te shkaktojne aksidente ose me veshtersi shikimi.

Zakonisht bizhuterinat nuk perdoren në shkollë në se femija juaj ka nevojë të përdorë bizhuterinë për arsye fetare ju lutem flisni me mesuesen kujdestare. Nxenesit mund të vënë sahat dhe vathë. Zakonisht vathet duhet të hiqen në orën e fiskuturës. Kjo është për arsye sigurimi. Në se keni problem ju lutem flisni me mesuesin kujdestare.

Noti është pjesë e programi mësimor i shkollës. Në se dëshironi ta hiqni femijen nga noti ose të përdorni rroba speciale ju duhet të flisni me mesuesin kujdestare. Kostumet fetare duhet të respektohen dhe siguria e femijes garantohej.

### **A MUNDËT FEMIJA IM ME PASE TRANSPORT PËR NE SHKOLLË?**

Femijet kanë mundësi me pase transport në shkollë në se kanë nevojë edukuese speciale dhe duhet me pase një dokument që e verteton këtë.

Megjithatë është e aprovuar vetëm në se shkolla është me e afërta shkollë (e vendosur nga LEA), dhe është më tepër se dy milje larg nga shtëpia për nxënësit nën 8 vjeç,

dhe tre milje për nxënësit me moshën 8-16 vjeç. Në se femija shkon në një shkollë fetare transporti mund të sigurohet. Për informacione rreth transportit kontaktoni:

**Edukimin e Shërbimit të Pasagjërëve për Transport**  
**Tel: 0117 903 6331**

### **ÇFARË AKTIVITETESH TË MUNDSHMË KA PËRPARA DHE MBAS PUSHIMEVE TË SHKOLLËS?**

Shumë shkolla kanë kohën e drekës ose mbas shkollës aktivitetë,

zakonisht rreth nje ore mbas mesimit. Keta jane aktivitetet si sporti, drama, arti, kercimi, muzika dhe klubet e detyrave te shtepise. Disa aktivite jane falas por per disa ju duhet te paguani. Disa shkolla gjithashtu kane vakt mengjesi perpara mesimit te mengjesit. Ju mund ti gjeni te gjitha informacionet e aktiviteve perpara dhe mbas shkolles ne zyren e shkolles.

Disa shkolla ofrojne ndihme per mbajtjen e femijeve perpara dhe mbas orarit te shkolles. Kjo perfshine klubet e mengjesit, klubet e detyrave te shtepise dhe klubet mbas shkollore. Prinderit mund te paguajne per disa prej ketyre.

Në se ju punoni dhe keni nevojë për më gjete dike për më u kujdesë për fëmijet ose në pushimet, ndodhen shumë skema me çmime të arsyshme. Për informacionet rreth ku janë dhe si të aplikoni kontaktoni BAND (Shoqatën e Bristolit të Lagjes për kujdesin e fëmijëve ditën) në:

**Tel: 0117 9542128 ose**  
**Sherbimet e informacioneve për Fëmijë Tel: 0845 129 7217**  
**Linja që ju ndihmon për shërbimin është e hapur nga:**  
**8.00 të paradites deri në 4.00 të mbasdites të Hënë dhe të**  
**Premten**  
**8.00 të paradites deri në 8.00 të mbasdites të martën,**  
**Mërkurën dhe të Enjtën**

Ju jeni përgjegjës për fëmijet përpara dhe mbas shkolles çdo ditë. Në se ju keni nevojë për dike të kujdesit për fëmijet përpara dhe mbas shkolles, ju mund të kontaktoni **Sherbimet e Informacionit për Fëmijë** ( përdorni numrin e mëparshëm ). Përkthyes janë të mundshëm.

## **A MUNDËT FEMIJA IM ME PASE MESIME MUZIKE NE SHKOLLE?**

Mësuesit e **Sherbimeve Muzikore të Bristolit** vizitojnë shkollat dhe afrojnë kujdes në instrumente të ndryshme. Fëmijët bëjnë

mesim ne grupe te vogla jo me shume se kater. Do te kete pageese per mesimin e dhene. Në se jeni i interesuar ju mund te flisni me drejtorin. Jane disa mundesi qe femija te marre pjese ne koncertet muzikore.

## **ÇFARE ESHTË EKSPERINCA NE PUNE?**

Eksperienca ne pune eshte vendi ne te cilin studenti mban detyrat dhe detyrimet, pak a shume kur ata jane te punesuar, por me ngulmimin e aspektit te mesuarit ne eksperience. Qeveria i keshillon te gjithë studentet e rinj ne dy vitet e fundit te edukimit te tyre te plotesojne me shume se dy jave eksperience pune per ti pergaditur ne punet e jetes. Shkolla dytesore (secondary school) mund ti afrojne femijes tuaj informacione te metejshme rreth experiences ne pune qe nevojitet.

## **SI MUND TE PERFSHIHEM NE SHKOLLE SI PRIND?**

Në se ju keni kohe te perfshiheni direkt, jane shume lloje rruges qe ju mund te ndihmoni ne shkollen e femijes tuaj. Per shembull:

## **SHOQATA E PRINDERIT DHE MESUESIT (PTA) OSE E SHOQERISE**

Në se shkolla ka PTA, grupet e shoqërisë ose forumin e prindërve, kjo mund të jetë mënyra ideale për tu përfshirë, dhe mund të njohësh prindër të tjerë. Disa PTA mbledhin të ardhura dhe diskutojnë për gjërat e përditshme të shkolles.

## **ADMINISTRATORI I SHKOLLES**

Duke u bërë administratori i shkolles mund të jetë një mënyrë e mirë për të marrë pjesë, për me influencë në rregullat e famijes tuaj. Ti duhet të zgjidhësh nga prindërit të tjerë. Ju mund të merrni informacion prej shkolles si mund të bëni pjesë në administratën e shkolles.

## **AFRONI EKSPERIENCEN TUAJ**

Fol në shkollë për arritjet tuaja dhe si mund të ndihmoni në klasën e famijes suaj ose në shkollë përgjithsisht. Në shumë shkolla e mirëpresin prindërit dhe flasin me famijet për gjëra të ndryshme si për shembull për besimin e tyre, për vendin tuaj etj si pjesë e programit mesimor.

Fol në shkollë se si mund të marrësh pjesë.

## **CILAT JANË RREGULLAT SHTEPI-SHKOLLË?**

Rregullat shtëpi shkollë janë rreth shkollë duke punuar së bashku me prindërit. Ju mund të ju kërkohet të firmosni një kontratë duke ju bërë ju përgjegjës për atë çfarë famija ka nevojë gjatë marrjes pjesë në shkollë. Drejtori i shkolles do të bëjë dakort që ti jap

mundesi femijes suaj të mesoje dhe te arrise më të miren e mundshme. Femija duhet të bie dakort që të marrin pergjigjsite e pjeses se tije. Nuk është e detyrueshme ta firmosni këtë dokument.

## **PO NË QOFTE SE KAM NJE PROBLEM APO ANKESE?**

Ju mund ta vizitoni shkollen dhe të flisni me drejtorin, mesuesin e klases apo mesuesun e lendes. Ështe shume me rendesi që ju ta njihni mesuesen kujdestare apo mesuesin e lendes sa më shpejt që të jete e mundur dhe vazhdo të takoheni me ato deri sa femija i juaj të rehatohet. Ju mund te telefononi për një takim ose te shkoni tek shkolla gjate një dite shkolle. Në qofte se kjo nuk është e mundur atehere një leter e shkruar është në rregull. Disa shkolla kane kontakte/leximi ose liber i detyrave të shtepise ku ju mund të leni mesaxhe për mesuesin kujdestare apo mesuesin e lendes. Pothuajse te gjitha problemet mund të zgjidhen direkt ose nga mesuesja kujdestare ose nga drejtori.

Në qofte se ankesa dhe nuk është zgjidhur, ju duhet ti drejtoheni bordit drejtues së shkolles. Bordi drejtues i kerkohet të kete proçedura ankesa. Ato të tregojne se si ju mund te ankoheni zyrtarisht. Kerko në qofte se shkolla ka proçedura dhe ju ta a merrni një kopje. Bordi drejtues mund të kete nevoje të diskutoje me drejtuesia special te panelit të ankesave.

Autoritet Edukuese Lokale (LEA) duhet te kenë proçedura ankimimi. Në qofte se ankesa nuk mund të zgjidhet nga shkolla

ose ju nuk jeni të kenaqur me menyren se si është duke e zgjidhur shkolla, hapi tjetër ju duhet të gjeni rreth procedurave të LEAs në:

**[http://www.bristol-lea.org.uk/services/complaints\\_school\\_x.html](http://www.bristol-lea.org.uk/services/complaints_school_x.html)**

ose duke i kontaktuar në:

**Richard Waytt, Communication Manager, Department of Education and Lifelong Learning, Council House, College Green. Bristol. BS1 5TR. Tel: 0117 9036958**  
**Email: [richard\\_waytt@bristol-city.gov.uk](mailto:richard_waytt@bristol-city.gov.uk)**

Perfundimisht, në qofte se besoni se bordi drejtues ose LEA janë të 'paarsyeshem', ju mund të ankoheni tek Sekretarja e Shtetit në Departamentin e Edukimit dhe Pervojes (DEFS).

## PJESA 4

### Infomacionet shtese

#### Shkallat kyçe në Edukim

Shkalla kyç është një bllok vitesh në shkollën e femijes.

##### **Shkalla kyçe 1** mbulon moshat 5-7 vjeç

Kjo periudh mbulon fillimin e atij ose asaj deri sa te arrijne moshen shkollore të detyrshme. Në mbarim te të njëjtjes kohe viti shkollore ku shumica nxënësve arrine në ate klase moshen shate vjeç.

##### **Shkalla kyçe 2** mbulon moshat 7-11 vjeç

Kjo është periudha e fillimit në të njejtën kohe siç është fillimi i vitit shkollore i cili pjesa me e madhe e femijeve arrine në moshen tetë. Mbaron në të njëjtën kohe me vitin shkollore në të cilën shumica e nxënësve arrine moshen 11.

##### **Shkalla kyçe 3** mbulon moshat 11-14 vjeç

Kjo periudh fillon në të njejtën kohe me vitin shkollore ku shumica e nxënësve arrine moshen 12. Mbaron në të njëjtën kohe me vitin shkollore ne të cilën shumica e nxënësve arrin moshen 14

##### **Shkalla kyçe 4** mbulon moshat 14-16 vjeç

Kjo fillon në të njejtin kohe me vitin shkollore ku pjesa me e madhe e femijve arrine moshen 15 vjeç. Në fund me mbarimin e vitit shkollore ku shumica e nxënësve arrine në moshen e mbarimit të detyrshem.

## **LENDA E PROGRAMIT MESIMOR KOMBETAR**

### **Femijet e moshave Recepton (moshat 3-5 vjeç)**

Zonat e mesimit drejt Mesimit të Arritjeve të Hershme brenda Themelimit Shkollor janë:

- Personale, sociale, zhvillim emocional
- Komunikim, gjuhë dhe rrjellshmeri
- Zhvillimi Matematikore
- Njohori dhe Kuptim i botes
- Zhvillimi Fizik
- Zhvillimi Krijues

### **Shkolla Fillore:**

Shkalla Kyçe 1 dhe 2 (moshat 7-11 vjeç)

**Lendet e Programit Mesimor që studiohen në shkolla fillore janë:**

- Matematik
- Anglisht
- Shkence
- Vizatime dhe teknologji
- Informacion dhe komunikim teknologjik (ICT/IT)
- Histori
- Gjeografi
- Art
- Muzik

- Edukimi Fizik (PE)
- Edukim Fetar (RE)

### **Shkolla Dytore (Secondary School):**

Shkalla kyçe 3 (mosha 11- 14)

**Lendet e Programit Mesimor që studiohen tek Shkalla kyçe 3 përfshijnë të gjitha lendet e vështira të shkolles fillore plus gjuhë të huaja moderne.**

Shkalla kyçe 4 ( moshat 15-18 vjeç)

**Lendet e Programit Mesimor që studiohen tek Shkalla kyçe 4 janë:**

- Anglisht
- Matematikë
- Shkencë
- Edukim Fizik
- Teknologji
- Gjuhë të huaja moderne
- Kurse të tjera gjate pushimit
- Zgjedhje të kujtuara sipas preferencave të studentit.

## Organizata të tjera të ndihmueshme

### SHERBIMI PER TË RINJTË

Sherbimi për të Rinjt në Keshillin e Qytetit Bristol ka një projekt ku të rihte mund të marrin pjese falas ose tek Qendra e të Rijve ose tek një vend i marre me qira. Keto ndollen në zonat e meposhtme të qytetit dhe ato janë organizuar për të rinjt të moshave 13-19 vjeça.

| Veri dhe Qender të Bristolit   | Jug dhe Lindje Bristolit   |
|--|--|
| Ashley<br>Avonmouth<br>Easton<br>Brentry and Henbury<br>Lawrence Weston<br>Lokleaze<br>Southmead | Barton Hill & Lawrence Hill<br>Bedminster<br>Hillfields<br>Hartcliffe & Withywood<br>Knowle West<br>St Annes |

Në cilindo nga keto zona grupi dhe stafi dhe punetoret e seksionit vullnetare jane të bazuar dhe japin sherbim. Të rinjt mund të marrin pjese në çfare do mbledhjeje në cilendo zone.

Po ashtu ndodhen sherbime lojrash për të rinjt të moshave 8-14 vjeç. Ato janë në 4 vendodhje kryesore lojrash në keto zona:

- Easton (Felix Road)
- Lockleaze
- St Paul's
- Southmead

Shtesat në keto vende janë projekte lojrash dhe puntoret afrojnë hapësirë për moshat e ndryshme.

**Per detajet rreth aktiviteteteve Tel: 0117 353 2288**

## **CONNEXIONS**

Connexions është shërbim përkrahës Qeveritar për të gjithë të rinjtë e moshave 13 deri 19 vjeç. Ky shërbim ka si synim të afrojnë këshilla, udhëzime dhe mundësi zhvillimi personale për këto grupe, dhe të ndihmojnë për një trasmetim të bute drejt rritjes dhe jetes së punës. Afron ndihme praktike duke zgjedhur kurse të duhura dhe kareier me marrjen e zhvillimeve personale ndërmjet aktivitetesh sportive, performu art dhe aktivitete vullnetare. Po ashtu afron ndihme dhe këshilla në problemet e abuzimeve me droge, shëndetit seksual dhe ato të pashtëpi. **Këshilltaret Personal** nga Connexions punojnë në shkollat të ndryshme dhe kolegje. Në qoftë se doni të dini se çfarë ndihme mund të ju afroje Connexions për fëmijën tuaj kontaktoni shkollën ose kolegjin. Connexions mund të kontaktohet:

**Tel: 0117 987 3700**

## **LIBRARIT NË BRISTOL**

Librarit ndodhen në të gjitha zonat e Bristolit dhe ato janë falas për fëmijën tuaj të përdorur për kohët e studimit dhe të marrin uha libra. Kompiuterat janë të mundshëm në të gjitha Librarit e Bristolit për tu përdorur nga të rriturit dhe fëmijet. Interneti po ashtu është i mundshëm. Fëmijet mund ta përdorin printerin falas. Orari e hapjes janë të ndryshme pra ju duhet ta kontrolloni me librarian që ju përkatse.

## A ndodhen libra në librari në gjuhe të ndryshme?

Librat në gjuhe të ndryshme ndodhen në pothuajse të gjitha librarit. Në qofte se gjuha që ju kerkoni nuk është e mundshme, librat mund të porositen nga Librarija Qendrore.

**Tel: 0117 903 7216.** Ju po ashtu mund të kerkoni nga librarija lokale që ti blejnë disa libra në gjuhen tuaj.

| <b>Librarije Lokale</b> | <b>Adresa</b>                  | <b>Telefon</b> |
|-------------------------|--------------------------------|----------------|
| Avonmouth               | Avonmouth Road<br>BS11 9EN     | 0117 982 8872  |
| Bedminster              | East Street<br>BSY 4HY         | 0117 956 3452  |
| Bishopworth             | Bishopworth Road<br>BS13 7NL   | 0117 964 2094  |
| Cheltenham Road         | Cheltenham Road<br>BS6 5QX     | 0117 942 4160  |
| Clifton                 | Princes Victoria St<br>BS8 4BX | 0117 973 0315  |
| Eastville               | Muller Road<br>BS5 6XP         | 0117 951 6014  |
| Filwood                 | Fillwood Broadway<br>BS4 1JN   | 0117 966 1671  |
| Fishponds               | Fishponds Road<br>BS16 3UP     | 0117 965 368?  |
| Hartcliffe              | Peterson Square<br>BS13 0EE    | 0117 964 2353  |
| Henbury                 | Crow Lane<br>BS10 7DR          | 0117 950 1969  |
| Henleaze                | Northumbria Drive<br>BS9 4HP   | 0117 9622417   |

|                 |                              |               |
|-----------------|------------------------------|---------------|
| Hillfields      | Summerleaze<br>BS16 4HL      | 0117 965 3249 |
| Horfield        | Filton Avenue<br>BS7 0BD     | 0117 969 2928 |
| Knowle          | Redcatch Road<br>BS4 2EP     | 0117 977 6304 |
| Lawrence Weston | Stile Acres<br>BS11 0QA      | 0117 982 2432 |
| Marsbury Rd     | Marksbury Road<br>BS3 5LG    | 0117 966 3144 |
| Redland         | Whiteladies Road<br>BS8 2PY  | 0117 973 5985 |
| Sea Mills       | Sylvan Way<br>BS9 2NA        | 0117 968 1532 |
| Shirehampton    | Station Road<br>BS11 9TU     | 0117 982 2184 |
| Southmead       | Greystoke Avenue<br>BS10 6AS | 0117 950 7107 |
| St George       | Church Road<br>BS5 9AL       | 0117 955 6277 |
| Stockwood       | Stockwood Road<br>BS14 8PL   | 01275 837 623 |
| Trinity Road    | Trinity Road<br>BS2 0NW      | 0117 955 6202 |
| Westbury        | Falcondale Road<br>BS9 3JZ   | 0117 950 2527 |
| Wick Road       | Wick Road<br>BS4 4EH         | 0117 977 6314 |
| Mobile Library  | c/o Bedminster               | 0117 9637622  |

## **ÇFARË INFORMACIONI ËSHTË I MUNDSHËM PËR TE ME NDIHMUR MUA PER TE PËRKRAHUR FËMIJËN TIM?**

Kopjet e disa fletushkave që mund të ndihmojnë në përkrahjen për edukim e fëmijës suaj janë të mundëshme në disa gjuhë. Ju mund ti porosisni në shkollë ose mund të merrni kopje duke kontaktuar

**Departamenti për edukim dhe përvojës (DFES)  
në Tel: 0845 602 2260.**

### **Udhëzues për të mësuar :**

- Udhëzues për prindërin për programin mësimor të shkollës fillore
- Udhëzues për prindërin për programin mësimor të shkollës dytesore (secondary school)

Duke mesuar rreth Matematikes në shkolle dhe në shtëpi

### **Vidio:**

- Matematik në shtëpi dhe në shkolle
- Lexim dhe shkrim se bashku: Duke mesuar në Shtëpi dhe Shkolle

### **Faqe interneti(Websites)**

DFES ka organizu një faqe interneti për prinderit, e cila ka informacione dhe burime të duhura. Një numer i madh i fletushakve në 11 gjuhë të ndryshme komunitare mund ti gjeni në këtë faqe. Ju mund ti gjeni në:

[www.parentscentre.gov.uk](http://www.parentscentre.gov.uk)

Kjo faqe interneti po ashtu lejon të **Veshtrosh Shkollat** me ane të emrit ose postkodit për:

- Renditjen e rezultateve performance
- Reportet e fundit
- Faqen e internetit të shkolles , në qofte se kane një.

Faqja **Vendet që mund të Shkoni** të informon për ngjarjet që ndodhin në zone për femijen tuaj. Kjo faqe interneti po ashtu të lidhe më burime tjera për të ndihmuar femijen tuaj të mesoje.

Sherbimi Informativ i Femijeve ka nje database, që të ndihmon rreth aktiviteteve/perkrahjeve për femijet dhe familjet. Faqja e internetit tyre është:

[www.cisbristol.co.uk](http://www.cisbristol.co.uk)

Faqja e internetit për Arritjet e Minoritetit Etnike është:

<http://emas.bristol-lea.org.uk>

Këtu ndodhen udhezime dhe informacione në lidhje më perkrahjen nxënësve të minoritetit etnik në shkolle. Po ashtu ndodhen detaje e ngjarjeve lokale dhe kombetare që mund të jenë në lidhje me minoritetet etnike.

Keto mund të përfshijnë festimin e një festivali fetar, festimi i një ngjarje historike, perkujtimi i ndonjë figure historike dhe panairi i librit.

Po ashtu të përfshire janë reklamimi i barazise racore ose festimi i kulturave të larmishme.

**LEA's Barazi dhe Grupi Përfshires** kanë faqene tyre të internetit në lidhje me rregullat dhe ligjet që shkollat duhet të ndjekun kundrejt barazise racore dhe zonat tjera etj, kercenim racore, konsulltim dhe punesim.

**Connexions** ka një faqe konfindenciale për të gjithë të rinjtë të moshave 13-19 vjeç. Kjo faqe i pergjigjet edukimit dhe pyetjeve tjera që mund të shqetesojne të rinjt. Ato mund të kontaktohen në:

**Tel: 0117 987 3700**

[www.connexions.gov.uk](http://www.connexions.gov.uk)

## Adresa ndihmese

**KESHILLI I QYTETIT  
BRISTOL DEPARTAMENTI I  
EDUKIMIT DHE  
JETGJATESISE MESIMORE**

Tel: 0117 903 7142  
Faks: 0117 903 7147

**Grupi i Pranimit  
(Admision Team)**

Po Box 57  
College House  
College Green  
Bristol BS99 7EB  
Tel: 0117 903 7694  
Faks: 0117 903 7710

**Ethnic Minority Achievement  
Service (EMAS)**

Bristol Education Centre  
Sheridan Way  
Horfield  
Bristol BS7 0PY  
Tel: 0117 903 1365  
Faks: 0117 903 1369

**Awards Section**

PO Box 1111  
College House  
College Green  
Bristol BS99 2EZ  
Tel: 0117 903 666

**Equalities and Inclusion  
Team.**

**Education and Lifelong  
Learning.**

College House  
College Green  
Bristol BS99 7EB  
Tel: 0117 903 77 22

**Education of Children  
Looked After Service  
(Looked After Children  
Service)**

1B Amercombe Walk  
Stockwood  
Bristol BS14 8AB  
Tel: 0117 3773062

**Refugee and Asylum  
Sekeers Team**

Ky grup mund të kontaktohet  
tek zyra e EMAS  
Tel: 0117 903 1279

**Sherbim Edukimi Mireqenes  
(Education Welfare Service)**

Kings House  
Bond Street  
Bristol BS1 3AE

**Special Education Needs  
(SEN) Section**

College House  
College Green

Bristol BS99 7EB  
Tel: 0117 903 7735  
Faks: 0117 903 7738

**Jashte Departamenteve**

Asylum Seekers Team  
Manager

Social Services/Health

Tel: 0117 903 6672

Email:

[sswla@bristol-city.gov.uk](mailto:sswla@bristol-city.gov.uk)

Connexions West England  
Floor 1, 4 Colston Avenue  
Bristol BS1 4ST

Tel: 0117 987 3700

Faks: 0117 987 3701

**Refugee Action**

Senate House

36 Stoke Croft

Bristol BS1 3QD

Tel: 0117 989 2100

**Social Services and Health**

Tel: 0117 903 6684

Faks 0117 989 6688

Email: [caredirect@bristol\\_city.gov.uk](mailto:caredirect@bristol_city.gov.uk)

**Avon Consortium for  
Traveller Education Service  
(Traveller Education  
Service)**

Charborough Road

Filton

Bristol BS34 7RA

Tel: 01454 862620

www.

[sothglos.gov.uk/traveller\\_ed](http://sothglos.gov.uk/traveller_ed)

**Supportive parents for  
Special Children**

3<sup>rd</sup> Floor, Royal Oak House

Royal Oak Avenue

Bristol BS1 4GB

Informacion dhe Perkraheje:

Tel: 0117 9897725

Admin& Faks: 0117 9897724

Email:

[supportiveparent@aol.com](mailto:supportiveparent@aol.com)

**Connexions**

**Young People's Service**  
**Administrative**  
**Headquarters**  
 Avonquay  
 Cumberland Basin  
 Bristol BS1 6XL  
 Tel: 0117 353 2277  
 Faks: 0117 353 2288

|             | <b>Periudha Terminologjike</b>  | Shikoni Faqen |
|-------------|---|---------------|
| Kolegj i FE | Kolegji më Edukim të metejshem ku femijet mund të studjojnë mbas 16 vjeç ose më heret | 14            |
| DfES        | Departament për Edukim dhe përvijë është pjesë e qeverisjes përgjegjëse për edukim    | 19            |
| EAL         | Anglishtja si gjuhë shtesë  | 19            |
| EMAG        | Ethnic Minority Achievement Grant   | 19            |

|                     |   |    |
|---------------------|---|----|
| EMAS                | Ethnic Minority Achivment Service                               | 19 |
| EWS/EWO             | Education Welfare Services/ Education Welfare Officier          | 20 |
| Shkalla Themeluese  | Program Mesimor për femijet e moshave 3-5 vjeç                  | 13 |
| GCSE                | Certificate Gjenerale për Edukim Dytesore (Secondary Education) | 13 |
| IEP                 | Plan Edukimi Individual për femijet me nevoja speciale edukuese | 17 |
| Shkalla Kyç         | Një bllok vitesh në shkollë                                     | 12 |
| LEA                 | Autoritete Edukuese Lokale                                      | 1  |
| Keshilltare Mesimor | Të punesuar për perkrahje mesimi dhe pjesmarrjen e femijeve     | 16 |
| LSA                 | Asistenta Perkrahes Mesimdhenie                                 | 16 |
| PRU                 | Dega Referuese e Nxënësve                                       | 22 |
| PTA                 | Shoqata Mesues Prinder, disa here quhet 'Shoqerija'             | 27 |
| Klasa Reception     | Viti i pare i shkolles fillore dhe Infant                       | 6  |
| SATS                | Provat e arritura ligjore                                       | 13 |
| SEN                 | Nevojat Speciale Edukuese                                       | 17 |
| SENCO               | Kordinatore e Nevojave Speciale Edukuese                        | 17 |
| SNSA                | Ndihmes Supervaizer për Vakthet Shkollore ("Dinner Lady")       | 16 |
| Deklaratat          | Deklaratat e nevojës dhe perkrahjes për femijet me SEN          | 17 |
| TA                  | Ndihmes Mesues  | 16 |

Edukimi dhe Jetegjatesija e Mesimdhënies  
(Education and Lifelong Learning)

Në qofte se keni nevojë këtë document të prodhohet në format të ndryshëm siç është Braille (për ato të verberit), print më të madh, kasete ose disk kompiuteri, ose në gjuhën e komunitetit, ju lutem kontaktoni:

Ethnic Minority Achievement Service (EMAS)  
Bristol Education Centre  
Sheridan Road

Horfield  
Bristol BS1 0PU

Tel: 0117 903 1365  
Faks: 0117 903 1369